

# Raporti i parë tremujor nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvend

(shtator –nëntor 2015)

---

*Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim*

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” - Shkup (IDSCS) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikpamjet e Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim.*



Instituti për demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSCS) nga qershori i vitit 2014 e përcjell cilësinë e debatit në Kuvend. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua gjatë 10 muajve, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015<sup>1</sup>. Nga shtatori i vitit 2015 monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së debatit parlamentar vazhdon i përkrahur nga Agjensioni zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim dhe do të zgjas deri më dhjetor të vitit 2017.

Monitorimi në këtë periudhë fokusohet në diskutime në lidhje me rendin kuvendor të ditës, që ka të bëjë me sundimin e ligjit, të drejtave të njeriut dhe demokracisë. Në këtë drejtim monitorohen të gjithë ato trupa kuvendore në fushëveprimin e të cilave bëjnë pjesë këto tema. Përveç kësaj, në kuadër të projektit janë të përfshira edhe mediat, përkatësisht përcillet se si ato raportojnë për punën e Kuvendit.

Të dhënat nga monitorimi për cilësinë e debatit në Kuvend dhe nga raportimi mediatik do të publikohen në formë të raporteve tremujore. Para jush është raporti i parë tremujor për cilësinë e debatit në Kuvend, për periudhën nga 1 shtatori deri më 30 nëntor të vitit 2015.

## I. Rezyme

- **Kthimi i opozitës në Kuvend solli ndryshim në më tepër aspekte të cilësisë së diskutimeve parlamentare** në periudhën nga 1 shtatori deri më 30 nëntor, 2015 në krahasim me periudhën nga 1 qershor 2014 deri më 31 Maj 2015.
- Në periudhën prej tre muajve (shtator, tetor dhe nëntor i vitit 2015) janë analizuar 1660 diskutime të deputetëve të paraqitura rreth 51 pikave të ndryshme të rendit të ditës të seancave kuvendore të cilat kanë të bëjnë me temat si sundimi i të drejtës, të drejtat dhe liritë e njeriut dhe financat publike. Në ciklin paraprak të monitorimit (qershor 2014 – maj 2015) kur mungonte pjesa më e madhe e deputetëve opozitarë dhe u analizuan të gjitha pikat e rendit të ditës të seancave të monitoruara në periudhë prej 10 muajve, u analizuan gjithsej 2271 diskutim. Kjo vë në pah **rritjen e vullshme të intensitetit të diskutimeve kuvendore si pasojë e kthimit të opozitës.**
- **Në mënyrë drastike është rritur ndërveprimi midis deputetëve nga blloqet e ndryshme politike** në parlament, gjë e cila vërehet përmes përqindjes së replikave dhe kundër-replikave. Në replikat shkon pjesa më e madhe e rasteve të analizuara – 75%.
- **Shkalla e argumentimit ka rënë në mënyrë drastike krahasuar me periudhën paraprake, duke e pasur parasysh se më të përfaqësuarat janë diskutimet pa kurrfarë arsytimi të pozicioneve.** Në vendin e dytë janë ato në të cilat është identifikuar një argument, mandej vijojnë diskutime në të cilat arsytimi i pozicioneve është i dobët. Diskutimet në të cilat

---

<sup>1</sup>Cikli i parë i cilësisë së debatit dhe të raportimit mediatik u zhvillua në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz. Përforcimi i debatit politik dhe i diskursit deliberativ” i financuar nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – EIDHR dhe i bashkë-financuar nga IDSCS dhe IEKOB. Raportin e plotë për cilësinë e debatit në ciklin e parë të vëzhguar i cili e përfshiu periudhën nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015 është i qasshëm në linkun vijues: <http://idscs.org.mk/images/parliament-watchdog/rovovska-debata-mk.pdf>

deputetët shfaqin nga dy ose më tepër se dy argumente janë më pak të përfaqësuara në periudhën e monitoruar.

- **Pjesa më e madhe e diskutimeve në seancat e monitoruara janë paraqitur nga deputetët e opozitës** - 55%, ndërsa më pak - nga deputetët e shumicës në pushtet – 45%.
- Njëlloj si edhe në ciklin paraprak të monitorimit edhe në periudhën shtator – nëntor 2015 **deputetët mbetën të mbyllur për argumentet e huaja dhe për mundësinë e ndryshimit të pozicionit të tyre**. Janë shënuar vetëm tre raste të vënies në pah nga deputetë se do ta ndryshojnë pozicionin e tyre për shkak të argumenteve të paraqitura nga deputetët e opsionit tjetër politik.
- Gjatë kësaj periudhe të monitoruar (shtator – nëntor 2015) **deputetët në përgjithësi ishin të orientuar drejt diskutimit me kundërshtarët e tyre politik në kuvend dhe pothuajse nuk u bënëin vështrim diskutimeve të bashkë-partiakëve të tyre**. Me këtë rast, ndaj argumenteve dhe personalitetit të kundërshtarëve të tyre në pjesën më të madhe nuk kishin ndonjë vlerësim, ndërsa në pjesën më të vogël shfaqnin respekt.
- **Deputetët nga shumica dhe nga opozita pothuajse në të njëjtën përqindje nuk u përgjigjën në mënyrë të drejtpërdrejtë në argumentet dhe pyetjet të cilat ju ishin drejtuar atyre, por vetëm pjesërisht**, ndërsa pjesërisht argumentet e drejtuara i injoruan ose i shtrembëruan. Deputetët nga opozita diç më shpesh në mënyrë të drejtpërdrejtë i adresuan argumentet të cilat u janë drejtuar nga deputetët e tjerë, ndërsa deputetët nga pushteti më shpesh tërësisht i injoruan argumentet të cilat u drejtuan nga diskutuesit e tjerë.
- **Pjesa më e madhe, përkatësisht pothuajse dyfish më tepër nga diskutimet e analizuara, i përbënin deputetët (burra) – 66% , në llogari të deputeteve të cilat përbëjnë 34% të diskutimeve.**

## II. Konteksti politik

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Parti demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO – DPMNE) fitoi 61 deputet ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin e themeluan Qeverinë, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvend fituan partitë e Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (RDK). Deputeti i cili mandatin e vet e fitoi nga RDK edhe krahas vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin iu bashkëngjiti grupit të deputetëve të BDI-së. Me atë, tani grupi i deputetëve i BDI-së numëron 20 deputetë. Më 8 maj partia Përtëritja demokratike për Maqedoninë (DOM) e cila ka një deputet (Liljana Popovska) në Kuvend, vendosi ta braktis koalicionin qeverisës. Në periudhën nga 20 qershori i vitit 2014 deri në fund të gushtit të vitit 2015, deputetët e koalicionit më të madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotoi punën e Kuvendit. Nga 1 shtatori i vitit 2015 deputetët e koalicionit të LSDM u kthyen në parlamentin dhe morën pjesë në punën e tij.

Partitë më të mëdha nga pushteti dhe opozita pas periudhës së vullshme të krijuar pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në prill të vitit 2014 në të cilën u publikuan një varg skandalesh të ndërlihdura me përgjimin e paligjshëm dhe në të cilën ndodhën protesta, më 2 qershor me

ndërmjetësim të komisionarit për zgjerim të UE-së Johanes Han arritën marrëveshje<sup>2</sup>për tejkalimin e krizës. Marrëveshja përmban një varg masash me afate konkrete të cilat duhet të ndihmojnë që të tejkalohet kriza politike e cila u zhvillua pas shpalljes së bisedave të përgjuara. Masat kanë të bëjnë me kthyerjen e opozitës në Kuvend, organizimin e zgjedhjeve të reja parlamentare, dorëheqje të qeverisë aktuale, formimin e qeverisë në të cilën në resorë kyç do të emërtohen ministra nga opozita, reforma në legjislativin zgjedhor, themelimin e prokurorisë speciale publike me mandat që ti hetojë akuzat në incizimet e shpallura.

Ndërkohë, ekipi i ekspertëve i angazhuar nga Komisioni evropian i udhëhequr nga Rajnhard Pribe, drejtor i mëparshëm i Drejtorisë për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian përgatiti raport të detajuar për problemet në më tepër sfera. Raporti vështron drejt sistemit gjyqësor, kontrollit të punës së shërbimeve të sigurisë, problemeve gjatë organizimit të zgjedhjeve, gjendjes në media dhe udhëzime për reforma në të gjitha këto fusha, e qëllimi i kësaj është përmirësimi i gjendjes. Raporti i është dërguar Kuvendit dhe shërben si udhërrëfyes për zbatimin e reformave në sferat e theksuara.

Nga 1 shtatori opozita u kthye në Kuvend dhe tani ai punon në përbërje të plotë. Në periudhën e monitoruar shtator – nëntor të vitit 2015 shumica në pushtet numëron 81 deputet, ndërsa opozita 42 deputet.

Sipas marrëveshjes, opozita në tetor morri disa poste ministore në qeverinë e Gruevskit, si në ministrinë e punëve të brendshme dhe atë të punës e politikës sociale. Zëvendës ministra opozitare janë vendosur në ministrinë për financa dhe atë të bujqësisë, me qëllim për ta kontrolluar punën e institucioneve kyçe shtetërore në periudhën e zbatimit të zgjedhjeve.

Partitë me disa zvarritje në negociatat të cilat zhvillohen midis grupeve të tyre të punës në Klubin e deputetëve me ndërmjetësim të lehtësuesit Piter Vanhoute i angazhuar nga UE dhe SHBA, i shkelën afatet të kontraktuara paraprakisht për zbatimin e reformave. Ende (gjendja në janar të vitit 2016) vijojnë negociatat për sferat jurisprudencë dhe mediat.

Sipas “Marrëveshjes nga Përzhino” qeveria e kryeministrit Nikolla Gruevski gjatë janarit të vitit 2016 duhet të parashtrojë dorëheqje dhe një qeveri kalimtare duhet të organizojë zgjedhje të reja parlamentare të cilat duhet të mbahen në prill të vitit 2016.

Deputetët në Kuvend nga që të dy opsionet politike pothuajse pa diskutim i pranuan vendimet e arritura në negociatat ndërpartiake jashtë nga Kuvendi. Në seancat kuvendore deputetët menjëherë i përkrahën dhe votuan vendimet e propozuara si themelimi i Prokurorisë speciale publike, zgjedhjen e prokurorit special publik, zgjedhjen e ministrave opozitarë, formimin e komisionit anketues për skandalin e përgjimit, emërtimin e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve...

### III. Gjetje nga monitorimi

- **Lloji i diskutimeve**


---

<sup>2</sup> Marrëveshja në opinionin e fitoi emrin “Marrëveshja e Përzhinos” sipas lagjes në Shkup në të cilën është e vendosur rezidenca e UE në të cilën u zhvilluan negociatat politike midis liderëve të katër partive më të mëdha politike në Maqedoni, VMRO – DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH.

Në periudhën e monitoruar për vetëm tre muaj u analizuan 1660 diskutime të deputetëve gjë e cila vë në pah rritjen e ashpër të intensitetit të debatit në parlament. Për krahasim, në periudhën paraprake të monitoruar nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015, për dhjetë muaj janë analizuar gjithsej 2271 diskutime. Diskutimet në periudhën shtator – nëntor të vitit 2015 janë paraqitur në kuadër të 51 pikave nga rendi i ditës i seancave plenare dhe në seancat e trupave punuese që janë të ndërlidhura me temat si sundimi i të drejtës, të drejtat dhe liritë njerëzore, transparencë dhe llogaridhënie<sup>3</sup>.

Sipas llojit, pjesa më e madhe nga diskutimet u bie replikave (37%) dhe kundër-replikave (38%), përkatësisht 75% nga diskutimet e analizuara i kanë takuar njërit nga këto dy lloje të diskutimeve.<sup>4</sup> Vetëm 19% nga të gjitha diskutimet shkojnë në fjalimet. Ky është dallim i madh krahasuar me periudhën paraprake të monitoruar (qershor 2014-maj 2015) kur nga numri i përgjithshëm i diskutimeve 72% ishin fjalime, 14% replika dhe 14% kundër-replika.

Nëse analizohet sipas përkatësisë politike të diskutuesve, në periudhën shtator-nëntor të vitit 2015, pjesa më e madhe e fjalimeve i përkasin deputetëve të opozitës – 65%. Replika më shpesh kanë deputetët nga pushteti – 57%, ndërsa pjesa më e madhe e kundër-replikave janë paraqitur nga opozitarët – 61%. Pjesa më e madhe e pyetjeve të deputetëve i shkojnë opozitës 71%, ndërsa deputetët e pushtetit kanë më shumë plotësime të pyetjeve të deputetëve – 55%.



## • Shkallë e argumentimit


Me rritjen e ndërveprimit midis deputetëve dhe thellimin e diskutimeve, u zvogëlua shkalla e argumentimit të diskutimeve. Sipas asaj sa argumente janë të identifikuar në fjalimet e deputetëve pothuajse një e treta u bie diskutimeve në të cilat nuk është vërejtur kurrfarë arsytimi i pozicioneve - 31%. Gjysma e dytë - 30% janë diskutime në të cilat është vërejtur një argument me të cilin folësi e ka arsyetuar pozicionin e vet. Në 23% të diskutimeve arsytimi është i dobët, përkatësisht deputeti ka prezantuar ndonjëfarë arsytimi, por kjo nuk mjafton që të llogaritet si argument i plotë. Dy

<sup>3</sup>Komisioni për financim dhe buxhet, Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive, Komisioni anketues për skandalin me përgjimet, Komisioni për mbikëqyrje të masës sëposaçme hetimore përcjellje të komunikimeve nga Ministria e punëve të brendshme, Drejtoria për polici financiare, Drejtoria e doganave dhe Ministria e mbrojtjes si dhe Agjensioni për zbulim.

<sup>4</sup> Në sajë të Rregullores së punës së Kuvendit fjalimet në seancat kuvendore janë kufizuar në 10 minuta. Replikat zgjasin 3 minuta, ndërsa kundër-replikat 1 minutë. Përfundim nga ky rregull janë seancat në të cilat debatohet për Buxhetin në Komisionin për financa dhe buxhet në të cilat anëtarët e trupit punues gjatë debatit të përgjithshëm mund të flasin vetëm dy herë në kohëzgjatje prej gjithsej 20 minuta, ndërsa koordinatori i grupit të deputetëve gjithsej 30 minuta.


argumente janë vërejtur vetëm në 9%, ndërsa më tepër se dy në 7% nga të gjitha diskutimet e analizuara të deputetëve.

Përqindje e madhe e diskutimeve – 31% në të cilat nuk ka kurrfarë arsytimi e pasqyron polarizimin e plotë politik të deputetëve. Këto diskutime më së shpesh kanë të bëjnë me adresimet e deputetëve në të cilat ato i sulmojnë kolegët e tyre nga opsioni i kundërt politik, duke shfaqur pikëpamje që kanë të bëjnë me tema të tjera, që janë të palidhura me temën e rendit të ditës, për të cilën kanë marrë fjalë. Deputetët në këtë periudhë shpesh herë bënë vështrim se si partitë politike janë sjell në të kaluarën ndaj problemeve të caktuara, në vend që të fokusohen në temat të cilat ishin në rendin e ditës në Kuvend.



Në pikëpamje të këmbimit të argumenteve, në 45% të diskutimeve të analizuara është vërejtur se ndaj folësit diskutimi i të cilit është analizuar nuk janë drejtuar pyetje ose argumente nga diskutuesi paraprak. Në 22% të rasteve nga diskutuesit paraprak janë drejtuar pyetje ose argumente dhe diskutuesi në mënyrë të drejtpërdrejtë u është përgjigjur argumenteve duke mos ju shmangur ose shtrembëruar. Në 19% të rasteve diskutuesi të cilit i janë drejtuar pyetje ose argumente, në diskutimin e vet u është përgjigjur vetëm një pjesë të tyre, ndërsa të tjerat ose i ka injoruar ose i ka shtrembëruar. Në 5% të diskutimeve diskutuesi tërësisht i ka injoruar argumentet ose pyetjet që i janë drejtuar atij.

Nëse kjo kategori analizohet përmes përkatësisë politike të diskutuesve të cilëve u janë drejtuar argumente ose pyetje nga diskutuesit paraprak, rezulton se në diskutimet e monitoruara opozitarët pak më shpesh u janë përgjigjur në mënyrë të drejtpërdrejtë argumenteve që atyre ua kanë drejtuar diskutuesit e tjerë - 58%, krahasuar me deputetët nga shumica – 42%. Në të dyja opsionet politike shkon përqindje pothuajse e njëjtë e diskutimeve në të cilat deputetët vetëm pjesërisht u përgjigjën në mënyrë përkatëse në argumentet e drejtuara, ndërsa pjesërisht i shtrembëronin ose injoronin ato argumente. Deputetëve nga shumica u shkon pjesa më e madhe nga diskutimet në të cilat diskutuesit nuk i injorojnë argumentet që atyre u janë drejtuar nga deputetët e tjerë, por në diskutimet e tyre i shtrembërojnë ato argumente dhe me këtë rast nuk e japin përgjigjen e kërkuar. Gjithashtu, deputetëve të shumicës u shkon pjesa më e madhe e diskutimeve në të cilat diskutuesit të cilëve u janë drejtuar argumente, argumentet tërësisht i injorojnë ose aspak nuk i referohen atyre.




- **Fuqia e argumentit më të mirë dhe në emër të kujt paraqiten argumentet**

Përkundër rritjes drastike të interaksionit midis deputetëve pasiqë opozita u kthye në shtëpinë ligjvënëse, mbetet e pandryshuar transparenca e deputetëve ndaj argumenteve dhe pozitave të huaja. Në periudhën shtator – nëntor të vitit 2015 në tri raste nga 1660, deputetët kanë vënë në pah se do ta ndryshojnë pozicionin e vet për shkak të argumentit më të mirë ose pozicionit të deputetëve të tjerë. Në dy raste bëhet fjalë për diskutime të deputetëve opozitarë, ndërsa në një rast për deputet të shumicës. Në periudhën qershor 2014 – maj 2015 në gjithsej 2271 diskutim u shënuar vetëm një rast i ndryshimit të pozicionit.


Në 49% nga fjalimet diskutuesit aspak nuk i kanë vështruar argumentet e shfaqura nga deputetët e tjerë. Në 43% të rasteve folësit aspak nuk e kanë njohur vlerën e argumenteve të prezantuara nga deputetët e tjerë. Këto raste diç më tepër shkojnë te diskutuesit e opozitës.

Në 5% të diskutimeve (79 raste)deputetët të cilët nuk kanë pozitë të njëjtë me diskutuesit paraprak (më shpesh nga opsioni i ndryshëm politik) e njohën vlerën e argumenteve të tyre. Në 4% deputetët të cilët kishin pozicion të njëjtë paraprak me diskutuesit e tjerë (më shpesh nga opsion i njëjtë politik) e pranojnë vlerën e argumenteve të paraqitura nga diskutuesit e tjerë. Marrë në përgjithësi, analiza sipas këtij kriteri vë në pah se transparenca dhe gatishmëria e deputetëve ndaj argumenteve të kundërshtarëve të tyre në periudhën e monitoruar është e vogël. Me fjalë të tjera, deputetët nuk demonstrojnë transparenca dhe gatishmëri për përkrahjen e pozicioneve të huaja me qëllim që vendimet që do të miratohen të jenë më gjithë-përfshirëse dhe në drejtim të të mirës së përgjithshme të të gjithë qytetarëve.



Në periudhën e monitoruar deputetët në pjesën më të madhe të diskutimeve të tyre – 38% i ndërlidhnin argumentet e paraqitura me të mirën e përgjithshme të të gjithë qytetarëve dhe të shoqërisë. Nëtë njëjtën përqindje është shënuar se diskutuesit kanë qenë neutral përkatësisht nuk i ndërlidhën argumentet e veta me përfitime ose pasoja eventuale nga ato për të gjithë qytetarët ose për grupe të veçanta. Në 12% të rasteve folësit nuk i ndërlidhën argumentet e tyre me përfitime ose pasoja për grupe të tjera. Nën nocionin grupe të tjera nënkuptohet grup politik, etnik, religjioz, profesional ose social me të cilin deputeti nuk identifikohet, por ndaj të cilës bën vështrim në diskutimin e vet dhe në emër të të cilës i orienton argumentet e veta. Në 11% nga diskutimet folësit i kanë ndërlidhur argumentet e veta me grupin të cilit i përkasin. Në 1% të rasteve deputetët i kanë ndërlidhur argumentet me parime abstrakte si paqe, mirëqenie, drejtësi sociale e kështu me radhë.

Deputetët nga opozita më shpesh i lidhin argumentet e veta me të mirën e përgjithshme të të gjithë qytetarëve, por edhe me grupet e veta dhe me grupe të tjera në shoqëri krahasuar me deputetët e shumicës.




- **Respekt, ndërprerje, kufizime dhe gjestikulime**

Deputetët në periudhën shtator-nëntor të vitit 2015 sillen në mënyrë të ndryshme ndaj argumenteve dhe ndaj folësve nga opsioni i ndryshëm politik krahasuar me periudhën paraprake të monitoruar nga qershori 2014 – maj 2015. Dallimi është në atë që në ciklin e parë të monitorimit kur në seancat kuvendore mungon pjesa më e madhe e deputetëve opozitar, diskutuesit më tepër shfaqin vlerësime ndaj diskutimeve dhe ndaj deputetëve nga opsioni i tyre politik me çka përqindja e respektit ishte më




e madhe - 42%. Në ciklin aktual të monitorimit kur deputetët u kthyen në parlamentin folësit pothuajse aspak nuk bënë vështrim ndaj argumenteve dhe ndaj deputetëve nga opsionet e tyre politike.

Në periudhën shtator – nëntor të vitit 2015 ndaj argumenteve të kundërshtarëve të tyre, folësit në 78% të diskutimeve nuk paraqitën kurrfarë vlerësimi, as pozitiv as negativ. Në 15% të rasteve shfaqën respekt, ndërsa në 6% respekt të pjesshëm. “Respekti i pjesshëm” do të thotë se folësit në pjesën më të madhe të diskutimeve të veta kanë shfaqur respektim ose kanë qenë neutral, ndërsa në pjesë më të vogël kanë shfaqur mos-respektim. Nëse raporti analizohet nga aspekti i përkatësisë politike të folësve, nga diskutimet në të cilat nuk është shfaqur kurrfarë raporti ndaj argumenteve të deputetëve të një partie tjetër shkojnë në folës nga opozita – 57%, ndërsa 43% të folësve nga shumica. Nga diskutimet në të cilat është shprehur respektim ndaj argumenteve të folësve të tjerë 53% janë të deputetëve opozitar, ndërsa 47% të deputetëve janë ata të shumicës. Nga diskutimet në të cilat është vërejtur respektim i pjesshëm ndaj argumenteve të deputetëve të tjerë, 61% shkojnë në deputetët nga shumica, ndërsa 39% në ato nga opozita.




Në raportin ndaj deputetëve të tjerë, folësit në ciklin e parë të monitorimit qershor 2014 – maj 2015 në 60% të rasteve kanë shprehur respektim. Kjo në pjesën më të madhe të rasteve kishte të bëjë me deputetët nga i njëjti opsion politik. Në periudhën aktuale të monitoruar shtator – nëntor 2015 në 60% të rasteve folësit nuk shfaqën kurrfarë vlerësimi për deputetët të tjerë nga opsion tjetër politik, ndërsa në 22% kanë shfaqur respektim. Në 13% shfaqën respektim të pjesshëm, ndërsa në 4% mos-respektim të pjesshëm, e në 2% mos-respektim të plotë ndaj personalitetit të deputetëve nga opsioni tjetër politik. “Mos-respektim i pjesshëm” do të thotë se folësit në pjesën më të madhe të diskutimeve i kanë sulmuar kolegët e vet në bazë personale, ndërsa në pjesën më të vogël kanë shfaqur respektim ose kanë qenë neutral. Si “mos-respektim” janë shënuar të gjitha rastet në të cilat folësit në diskutimet kanë shfaqur mos-respektim ndaj deputetëve të tjerë, përkatësisht i kanë sulmuar kolegët e tyre në baza personale ose partiake.


Nga aspekti i përkatësisë politike të folësve, një pjesë pak më e madhe e diskutimeve në të cilat është shfaqur respektim ndaj folësve nga partia tjetër u takon deputetëve opozitar – 53%. Te deputetët e shumicës shkon pjesë pak më e madhe e diskutimeve në të cilat është shënuar respektim i pjesshëm – 53%. Te deputetët opozitar janë vërejtur diç më tepër raste të mos-respektimit të pjesshëm – 52%, ndërsa te shumica diç më tepër raste në të cilat është shfaqur mos-respektim ndaj personalitetit të deputetëve nga opsioni tjetër politik – 54%.



Edhe përkundër diskutimeve intensive në periudhën shtator – nëntor 2015 numri i ndërprerjeve është relativisht i vogël. Vetëm në 4% të diskutimeve (59 raste) janë shënuar ndërprerje më të vogla se 10 sekonda. Këtu janë përfshirë ndërprerjet e shaktuara më shpesh me ndërhyrje në fjalë të folësit nga deputetët tjerë, me klithje ose komentim nga vendi ku janë të ulur, por pas ndërprerjes folësi e ka vazhduar fjalimin e tij. Në 2% nga diskutimet (38raste) folësit kanë vënë në pah se nuk janë në mundësi të diskutojnë për shkak të kufizimeve nga deputetët e tjerë në sallë, gjë e cila është bërë me zhurmë, ndërhyrje të zëshme dhe mos vëmendjes nga pjesëmarrësit e tjerë në seancë. Nuk është shënuar rast i kufizimit fizik të diskutimit të ndonjë folësi.



Në pikëpamje të komunikimit jo-verbal komunikimi në periudhën e monitoruar shtator – nëntor 2015 është vërejtur se folësit gjestikuluan në 60% të rasteve dhe atë në drejtim të plotësimit dhe theksimit të pjesëve të diskutimeve të veta. Në 9% të paraqitjeve është vërejtur se folësit kanë përdorur rekuizita me të cilat i plotësonin diskutimet. Kjo më shpesh ka të bëjë në prezantimin e dokumenteve dhe letrave të ndryshme të cilat nga foltorja ua kanë prezantuar pjesëmarrësve të tjerë dhe opinionit si plotësim të diskutimeve. Në 1% të rasteve është vërejtur se folësit kanë gjestikulluar ndaj pjesëmarrësve të tjerë në seancën, por nuk është shënuar rast në të cilin bëhet fjalë për gjestikullim ofendues ose sulmues ndaj deputetëve të tjerë. Në 30% nuk është vërejtur se folësit krahas deklarimit verbal kanë përdorur edhe komunikim jo-verbal.



#### IV. Demografia e folësve, propozues i aktit dhe procedura në të cilën shqyrtohet ligji

Struktura demografike e diskutuesve, diskutimet e të cilëve janë analizuar në periudhën shtator –nëntor 2015 është me sa vijon:


**Gjinia:** burra 66%, gra 34%

**Përkatësia etnike:** Maqedonas 94%, Shqiptarë 4%, të tjerë 2%;

**Opsioni politik:** pushteti 45%, opozita 55%

**Shkalla e arsimit:** me arsim të mesëm 0,18%, me arsim të lartë 68%, me studime pas-diplomike (magjistratura dhe doktoratura) 32% .

**Njësia zgjedhore:** NjZ1 10% , NjZ2 11%, NjZ3 24%, NjZ4 28%, NjZ5 21%, NjZ6 5% dhe NjZ8 1%.




Në periudhën e monitoruar diskutimet e deputetëve janë të paraqitura në seanca në të cilat pikat e rendit të ditës ishin:

**Lloji i aktit:** propozim-ligje 68%, ndryshime dhe plotësime të ligjit 19%, pyetje deputetësh 6% dhe akte të tjera 7%;

**Propozues:** deputetë 37%, Qeveria 61% dhe qytetarë 2%;

**Procedura në të cilën shqyrtohet:** Në procedurë të rregullt 87%, të shkurtuar 12% dhe urgjente 1%.



## V. Metodologjia e hulumtimit

Cilësia e diskutimit në Kuvend analizohet me përdorimin e “Indeksit të cilësisë së debatit”. Indeksi është instrument i cili mundëson që çdo akt i veçantë i fjalimit në seancën e monitoruar të kodohet sipas disa karakteristikave kryesore:

- Shkalla e argumentimit të fjalimit (sa argumente ka në çdo diskutim);
- Shkalla e respektimit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;
- Transparencë për pranimin e argumenteve të huaja dhe ndryshimi i qëndrimeve të veta për shkak të argumenteve më cilësore të paraqitura në debat;
- Nëse deputetët i arsyetojnë qëndrimet, në emër të interesave të kujt i përfaqësojnë qëndrimet e veta;
- Vallë a mund deputetët në mënyrë të papenguar ti shfaqin qëndrimet e veta.

Me monitorimin janë përfshirë debatet të cilat kanë të bëjnë me pika të rendit të ditës të ndërlidhura me temat: sundimi i të drejtës, të drejtat dhe liritë e njeriut, integrimet evropiane, financat publike dhe të tjera për të cilat do të konstatohet se janë në interes për hulumtimin. Në atë drejtim përcillen seancat plenare të Kuvendit dhe të trupave punuese vijuese:

- Komisioni për financim dhe buxhet;
- Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive;
- Komisioni për qështje të zgjedhjeve dhe emërimeve;
- Komisioni për vetëqeverisje lokale;
- Komisioni për çështje evropiane;
- Komisioni i përhershëm anketues për mbrojtje të lirisë dhe të drejtave të qytetarit;
- Komisioni juridiko-ligjvënës;
- Trupa të tjera punues.

## Projekti Kuvendi nën thjerrëz

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz” është i financuar nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim. Në pjesën e aktiviteteve përfshin monitorim 28 mujor të cilësisë së debatit kuvendor dhe monitorim të asaj se si mediat raportojnë për punën e Kuvendit.

Monitorimi i debatit kuvendor dhe i raportimit mediatik filloi në shtator të vitit 2015 dhe do të zgjas deri në dhjetor të vitit 2017 dhe do të përfshijë analizë dhe raportim për njohuritë e përfituara nga monitorimi në çdo tre muaj. Në periudhën e projektit do të përpilohen 9 raporte tremujore për cilësinë e debatit në parlamentin dhe 9 raporte tremujore për raportimin mediatik për punën e deputetëve. Në kuadër të projektit do të zbatohen dhe do të shpallen rezultatet e dy hulumtimeve në terren të opinionit publik për perceptcionet e qytetarëve për punën e Kuvendit.

Projekti paraqet vazhdimësi të projektit “Kuvendi nën thjerrëz përforcimi i debatit politik dhe diskursi deliberativ” i cili u financua nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – IIDHR dhe u realizua në periudhën nga muaji shkurt i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2015.